



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e V-të për vitin 2012, e Kuvendit Komunal në Vushtrri, mbajtur më 31.5.2012

Mbledhja është mbajtur në sallën e kuvendit komunal duke filluar në orën **10:10**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Arta Ismajli, Avdullah Halimi, Bahrije Pllana, Besim Jashari, Esat Beka, Ferit Idrizi, Gani Imeri, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Hajrulla Muli, Islam Krasniqi, Ismet Gashi, Makfirete Ademi, Merjeme Ismajli, Melihate Basholli, Muharrem Shabani, Naile Osmani, Nysret Gërxhaliu, Pajazit Pllana, Qazim Azemi, Refik Ramaj, Sabit Kadriu, Sabri Ferati, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Shpëtim Zhegrova, Syzana Sylja, Tasim Gubetini, Veli Karaça, Vlora Qirezi, Xhemajl Pllana, Xhylsime Feka dhe Zeqir Hasani.

Munguan: Ergin Sunguri, Remzije Isufi, anëtarë të kuvendit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: nënkryetari i komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të ICO-së (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Habib Mustafa - kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë.

Habib Mustafa, kryesues i kuvendit- paraqiti rendin e ditës ashtu siç është paraparë në ftesë, kurse në “të ndryshme” propozoi që të futen:

- a. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe harmonizimin e rishikimit të buxhetit për vitin 2012;
- b. Shqyrtimi i listës së propozuar nga komisioni për ndarjen e plaketave dhe mirënjohjeve;
- c. Shqyrtimi i propozimit për plotësimin e KPF-së me një anëtar;
- ç. Shqyrtimi i Deklaratës lidhur me kërkesat e pensionistëve për gjendjen e tyre tejet të rëndë sociale.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- tha se që nga viti 2010 të gjitha grupet parlamentare (duke iu referuar fjalimeve mbështetëse të përfaqësuesve të grupeve parlamentare) për projektin në fjalë janë dakorduar lidhur me kërkesën që të hyjë

në prioritet rruga që lidh fshatin Novolan, lagjen "Ferizi" në fshatin Bruznik dhe lagjen "Islamaj" në fshatin Kollë, me ç'rast tha se kjo rrugë ka qenë e propozuar si tërësi dhe ka qenë në prioritet, por në ndërkohë në rrethana të pasqaruara e ka hequr lagjen "Ferizi", kurse ka mbetur vetëm traseja që shkon vetëm deri në fshatin Kollë në lagjen "Islamaj". Pastaj tha se banorët e fshatrave në fjalë e kanë paguar projektin, dhe projekti në fjalë është futur si tërësi, duke shtuar se gjithmonë është potencuar se ato komunitete që participojnë me mjetet e veta për çfarëdo projekti, do të kenë përparësi, prandaj pyeti se si ka ndodhur të hiqet nga prioriteti rruga që ka qenë e planifikuar për t'u përfunduar si tërësi. Në fund kërkoi që rruga në fjalë të asfaltohet në tërësinë e saj ashtu siç ka qenë kërkesa dhe si është bërë projekti në fjalë nga banorët e fshatrave të cekur më lartë, pasi që ashtu edhe janë pajtuar të gjitha grupet parlamentare.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- e mbështeti çështjen e ngritur nga S.Kadriu dhe shtoi se në vitin 2010 iu ka drejtuar përmes një shkrese kryetarit të komunës lidhur me rrugën në fjalë. Po ashtu në vitin 2010 drejtori për ekonomi dhe bujqësi i ka kthyer përgjigje se rruga në fjalë hyn në kategorinë e projekteve kapitale dhe shtoi se kjo rrugë është votuar në vitin 2011, dhe kur është aprovuar buxheti për vitin 2012 prapë e ka potencuar rrugën në fjalë dhe ka hyrë, kurse tash banorët përsëri kanë bërë kërkesë ku thonë: "se kryetari i komunës duhet t'i ketë parasysht vendimet që janë marrë në kuvend, kërkesën e banorëve dhe nuk do të anashkalohej në baza partiake, përndryshe do të përdorim edhe forma tjera".

Sami Istrefi, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike- duke iu referuar kërkesës së banorëve në fshatin Kollë, lagjja "Islami", tha se në bazë të buxhetit të aprovuar me projekte thuhet "rregullimi i rrugës në fshatin Kollë-lagjja Islami", kurse projektin e përbashkët që është bërë në vitin 2010 nga lagjet "Ferizi dhe Islami", kryetari i komunës e ka dërguar këtë projekt në Ministrinë e Transportit, pasi që është një rrugë e gjatë afër 3 km, prandaj në atë kohë komuna me buxhetin e vet nuk ka pasur mundësi për rregullimin e rrugës në fjalë. Në fund tha se kuvendi i komunës ka ndarë 60.000 € për lagjen "Islami", por akoma nuk janë zhvilluar procedurat për shkak të kontesteve pronësore, pasi që një pjesë e saj është nën administrimin e Ibër-Lepencit, duke informuar se Ibër-Lepenci ka dhënë pëlqimin, dhe rruga në fjalë shumë shpejt do të rregullohet.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të LDK-së paraqiti vërejtje lidhur me pikën nr. 4 të rendit të ditës, pasi që disa herë ka kërkuar grupi parlamentar në fjalë dhe që është aprovuar kërkesa, që të gjitha ndryshimet që janë bërë në Rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, të integrohen në rregulloren në fjalë. Gjithashtu lidhur me Propozim-vendimin për ndryshimin dhe harmonizimin e rishikimit të buxhetit, tha se buxheti si dokumenti më i rëndësishëm i politikës fiskale duhet të përgatitet me kohë duke u studiuar në hollësi nga këshilltarët, kurse rishikimi i buxhetit nuk ka kaluar nëpër procedura ligjore, nuk ka kaluar përmes KPF-së, prandaj si i tillë, Grupi parlamentar i LDK-së kërkon që të hiqet nga rendi i ditës. Pastaj për "të ndryshme" propozoi që të futet kërkesa e cila iu është adresuar grupeve parlamentare nga banorët e fshatit Skoqne për meremetimin e rrugës dhe të kyçjes në rrjetin elektrik, pasi që atje mungon energjia elektrike.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- tha se grupi parlamentar i PDK-së e përkrah rendin e ditës me propozimet shtesë të paraqitura nga kryesuesi i kuvendit.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- tha se vendimi i kuvendit ka qenë që rruga (e përmendur më herët) të shtrohet në tërësi, prandaj pyeti se a po zbatohet apo nuk po zbatohet vendimi i kuvendit. Në fund kërkoi që të zbatohet ajo që është aprovuar në kuvendin e komunës.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- i sugjeroi kryesuesit të kuvendit që të kërkojë nga bashkëpunëtorët e tij dhe organet tjera që të mos anashkalohej ligji dhe rregullat e punës. Pastaj tha se KPF-ja duhet ta luajë rolin e vet, sepse po shihet që KPF-ja po anashkalohej duke mos i shqyrtuar çështjet me rëndësi në të, por vijnë në

kuvend pika të rëndësishme të rendit të ditës nga aparati administrativ, e jo nga ai politik, dhe shtoi se nuk mund ta diktojë me diktuar politikën e investimit të buxhetit, të taksave të qytetarëve të komunës një administrator, një drejtor apo një organ administrativ, pasi që kuvendi është organi më i lartë politik në komunë. Në vazhdim kërkoi nga MAPL-ja që shumë vendime duhet të përcillen, të monitorohen, të sugjerohen, dhe të japin vërejtjet rreth funksionimit të mirëfilltë të organeve. Në fund tha se në mbledhjen e KK-së të dt. 29.09.2011 rruga e përmendur nga S.Kadriu, ka qenë e aprovuar që të hyjë në prioritet, prandaj kërkoi trajtim të barabartë për të gjithë qytetarët qoftë për lagjet “Ferizi dhe Islamaj”, qoftë për lagjet tjera, prandaj propozoi që kjo çështje të kthehet, të rishqyrtohet gjithanshëm dhe të futet në rendin e ditës.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- kërkoi nga kryesuesi i kuvendit që të respektohet Rregullorja e punës së kuvendit dhe të mos i lejohet askujt që të diskutojë dy herë për një pikë të rendit të ditës. Kurse lidhur me rendin e ditës paraqiti vërejtje, pasi që po shkelet plani i punës së kuvendit, sepse disa pika të rendit të ditës që është dashtë të diskutohen në muajin mars, janë proceduar për diskutim në muajin maj. Po ashtu tha se edhe disa pika të rendit të ditës që kanë qenë të parapara për muajin prill, janë shtyrë dhe janë propozuar për diskutim në muajin maj, kurse ka edhe pika të rendit të ditës që janë paraparë me plan të punës për muajin maj, por që mungojnë në rendin e ditës për këtë muaj, prandaj pyeti se a duhet të mbahet dikush përgjegjës, pasi që për këto shtyrje pasojat janë evidente, dhe shtoi se rasti i arrestimit të drejtorëve në Komunën e Vushtrrisë ka pasur pasoja, pasi që në atë kohë është krijuar çrregullim i punëve. Pastaj kërkoi nga kryetari i komunës përgjigje me shkrim se a ndihet përgjegjës për këto zhagjitje dhe për pasojat që janë evidente në terren rreth këtyre zhagjitjeve.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- tha se pajtohet me rendin e ditës, duke përjashtuar pikën e rendit të ditës që flet për rishikimin e buxhetit, sepse kjo pikë nuk ka kaluar përmes KPF-së. Pastaj propozoi që në “të ndryshme” të futet një deklaratë lidhur me gjendjen e rëndë sociale të pensionistëve në Vushtrri dhe Kosovë. Mandej tha se sipas nenit 19 të Rregullores së punës së kuvendit mund të parashtrihen pyetjet në fillim të mbledhjes së KK-së, para se të aprovohet rendi i ditës.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- duke iu referuar kërkesës së S.Kadriut, tha se planifikimi për lagjen “Islami” ka qenë e përmendur decidivisht dhe nuk ka pasur emër tjetër, kurse lagjet “Menxhiqi dhe Xhafa” janë të planifikuara për këtë vit.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- në replikë ndaj Sh.Zhegrovës, e citoi përmbajtjen e fjalimit të tij në mbledhjen e KK-së, kur është debatuar për asfaltimin e lagjeve të përmendura më lartë, ku ka thënë se Grupi parlamentar i PDK-së përkrah asfaltimin e lagjeve “Ferizi dhe Islami”.

Dibran Përçuku, nënkryetar i komunës- duke iu referuar projekteve që iu është dhënë prioritet, tha se që 5 vite nuk ka ndodhur që kryetari i komunës apo qeveria komunale të ndërrojë projektet që janë aprovuar në kuvend. Pastaj propozoi që kërkesës së S. Kadriut për mbledhjen e ardhshme t’iu përgjigjet me shkrim.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar rendit të ditës, tha se pajtohet me rendin e ditës me të gjitha pikat shtesë, por jo edhe për pikën e rendit të ditës që flet për rishikimin e buxhetit.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, kuvendi me 16 vota “për”, 8 “kundër”, të tjerët “abstenim” miratoi këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e KK-së, mbajtur më 05.04.2012 dhe vazhduar më 30.04.2012.
2. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e KK-së, mbajtur më 08.05.2012.
3. Shqyrtimi i Informatës për të hyrat vetanake dhe shpenzimet për muajt: janar, shkurt dhe mars 2012.
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale (shqyrtimi i parë).
5. Shqyrtimi i Draft-rregullores për caktimin e kriterëve dhe mënyrën e ndarjes së shpërblimeve, mirënjohjeve, dekoratave dhe titujve të nderit (shqyrtimi i parë).
6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për entitetet publike dhe jopublike (shqyrtimi i dytë).
7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndërtimet dhe parandalimin e ndërtimeve ilegale gjatë vitit 2011.
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit mbi lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
9. Shqyrtimi i kërkesës së tri shoqatave të dala nga lufta rreth financimit të tyre.
10. Shqyrtimi i Informatës për fëmijët që punojnë punë të rënda.
11. Të ndryshme:
 - a. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe harmonizimin e rishikimit të buxhetit për vitin 2012;
 - b. Shqyrtimi i listës së propozuar nga komisioni për ndarjen e plaketave dhe mirënjohjeve;
 - c. Shqyrtimi i propozimit për plotësimin e KPF-së me një anëtar;
 - ç. Shqyrtimi i Deklaratës lidhur me kërkesat e pensionistëve për gjendjen e tyre tejet të rëndë sociale;
 - d. Pyetjet eventuale të anëtarëve të kuvendit.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e KK-së, mbajtur më 05.04.2012 dhe vazhduar më 30.04.2012.

Aprovohet në mënyrë unanime procesverbali i mbledhjes së KK-së, pa vërejtje dhe sugjerime.

2. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e KK-së, mbajtur më 08.05.2012.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- kërkoi që procesverbali në fjalë të plotësohet me propozimin e Z.Hasanit dhe të plotësohet me urimin e tij për kryesuesin e ri.

Aprovohet në mënyrë unanime procesverbali i mbledhjes së jashtëzakonshme të KK-së, me vërejtjen e Q.Azemit.

3. Shqyrtimi i Informatës për të hyrat vetanake dhe shpenzimet për muajt: janar, shkurt dhe mars 2012.

Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit- duke e përshëndetur paraqitjen në mënyrë profesionale të informatës në fjalë, paraqiti vërejtje lidhur me komentimin e pasqyrave, pasi që shumica nga deputetët nuk mund t'i zbërthejë këto pasqyra. Pastaj tha se informata në fjalë nuk përmban asnjë koment që i definon raportet e të hyrave dhe shpenzimeve. Gjithashtu në informatën në fjalë mungon aplikimi i metodës së krahasueshmërisë me vitin paraprak dhe se informata ka gabime të mëdha teknike. Kurse duke iu referuar të hyrave vetanake të realizuara për këtë periudhë, tha se ka munguar një angazhim i qeverisë komunale dhe i drejtorive përkatëse për realizimin e planifikuar të të hyrave vetanake, duke shtuar se realizimi i të hyrave vetanake për këtë periudhë, për vitin 2012 është më i vogël se në dy vitet paraprake, prandaj kërkoi një angazhim më të madh për të realizuar planifikimin e mundshëm. Po ashtu tha se në faqen nr. 4 të informatës në fjalë është një gabim te kategoria "biznese individuale" ku thuhet që realizimi është 76.55 %, kurse në faqe nr. 5 të njëjtat "taksa në firmë" janë të realizuara 50.92 %, po ashtu te "taksat rrugore" thuhet se ka realizim 3,738.00 %, prandaj kërkoi që të korrigjohen këto gabime të mëdha teknike në informatën në fjalë. Ndërsa lidhur me të hyrat vetanake, tha se ka rënie drastike te taksat komunale, po ashtu destinimi i tokës, lejet e ndërtimeve, kurse ka rritje në mbledhjet e të hyrave vetanake në tatimin në pronë. Në fund kërkoi sqarime nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, lidhur me faqen nr. 6, ku thuhet se donacionet e jashtme janë 2.160 €, ndërsa te faqja nr. 2 donacionet e jashtme marrin pjesë me 0 €.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- tha se i mbështet plotësisht konstatimet e Z.Hasanit. Pastaj tha se për nivelin e raportimit në kuvendin e komunës, të dhënat janë të kamufluara, dhe shtoi se kuvendit të komunës përveç raporteve teknike, duhet t'i dorëzohen edhe raporte menaxheriale. Pastaj tha se informata në fjalë nuk pasqyron të vërtetën, dhe si shembull përmendi totalin prej 72.36 % të pasqyruar në faqe 2, ku janë përfshirë edhe të mjetet e bartura nga viti i kaluar. Pastaj tha se të hyrat e realizuara për këtë tremujor në krahasim me planin janë 47.53 %, dhe shtoi se ka rënie në krahasim me periudhat e viteve të kaluara. Gjithashtu tha se në informatën në fjalë mungon krahasimi me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, mungon shtylla e të hyrave vetjake nga ngarkesat e viteve të kaluara dhe mungojnë të hyrat neto të ngarkuara të vitit 2012. Në fund kërkoi që për periudhën e ardhshme të përfshihen vërejtjet e paraqitura nga anëtarët e kuvendit në informatat e radhës.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- tha se informata në fjalë është paraqitur në formën standarde që është dërguar nga ministria përkatëse për të gjitha komunat dhe mund të ketë ndonjë gabim teknik tek përqindja, por do të korrigjohen. Kurse lidhur me donacionet e jashtme, tha se këto donacione barten prej vitit 2011 në vitin 2012 dhe shtoi se kanë qenë disa donacione nga Banka Botërore që janë paraparë për shkolla, d.m.th. janë paraparë për mallra dhe shërbime.

4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale (shqyrtimi i parë).

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- tha se pasi që ka pas ndryshime të shumta, është mirë që të unifikohet rregullorja në fjalë, në mënyrë që të mos ketë pengesa në zbatimin e saj. Pastaj tha se një çështje që duhet të trajtohet në mënyrë të gjithanshme është stimulimi i prodhimit dhe punësimit, ku dhe pyeti se me këtë rregullore, me këto ngarkesa komunale a po stimulohet diçka, dhe shtoi se disa degë suficitare që kanë përfitime të majme të shkohen në kufijt e normales, ndërsa te çështja e zejtarëve të ndryshëm, kërkoi të ketë një trajtim të veçantë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Ipet në diskutim publik Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Diskutimi publik fillon nga data 01.06.2012 dhe zgjat deri më 20.06.2012.

5. Shqyrtimi i Draft-rregullores për caktimin e kritereve dhe mënyrën e ndarjes së shpërblimeve, mirënjohjeve, dekoratave dhe titujve të nderit (shqyrtimi i parë).

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, tha se te neni 4, fjalia “kryetari i komunës” të zëvendësohet me fjalinë “kryesuesi i kuvendit”, pasi që të gjitha aktet që i nxjerr kuvendi, kompetent është kryesuesi i kuvendit, sepse kryetari i komunës i ndanë shpërblimet dhe mirënjohjet deri në shumën që përcaktohet dhe mirënjohjet, kurse dekoratat dhe shpërblimin më të lartë se sa shuma e përcaktuar, duhet t’i dorëzojë kryesuesi i kuvendit. Kurse për nenin 7 propozoi këtë formulim: “të drejtë për të paraqitur propozim për shpërblim, mirënjohje apo dekoratë e kanë individët dhe institucionet”, sepse neni 11 i sqaron kushtet për t’u propozuar për marrjen e një dekorate, shpërblimi apo mirënjohje. Gjithashtu te neni 14 propozoi që fjalia “kryetari i komunës” të zëvendësohet me fjalinë “kryesuesi i kuvendit”.

Veli Karaça, anëtar i kuvendit- shprehu keqardhje që rendi i ditës është aprovuar me 16 vota dhe kjo nuk flet mirë për punën e kuvendit. Kurse duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, tha se paragrafi 6.2 parashikon ndarjen e dekoratës “Qytetar Nderi i Vushtrrisë” vetëm për individët që nuk janë banorë të Komunës së Vushtrrisë, prandaj shtoi se nuk është mirë që të përjashtohen qytetarët e Vushtrrisë, në raste të veçanta për kontribute të jashtëzakonshme, dhe për këtë arsye kërkoi që të mos figuron fjalia “të mos jenë qytetarë të Komunës së Vushtrrisë”. Ndërsa duke iu referuar paragrafit 6.3, tha se kufizimi nuk është i mirë, për shkak se “Çelësi i Qytetit” mund t’i jepet edhe individëve që nuk përfaqësojnë institucione të larta, por që kanë kontribuar në lëmi të ndryshme në: art, shkencë, kulturë, muzikë etj, prandaj në emër të Grupit parlamentar të LDK-së propozoi që ky nen të ndryshojë.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të PDK-së e përkrah draft-rregulloren në fjalë, dhe shprehu pajtimin me diskutimin e I.Gashit. Kurse duke iu referuar nenit 4, tha se ky shpërblim duhet të dhurohet përmes xhirrologarisë. Te paragrafi 6.2, tha se “Qytetar Nderi i Vushtrrisë” duhet të zgjedhet individ që nuk është i Vushtrrisë. Në fund lidhur me paragrafin 6.2 dhe 6.3 propozoi që të përcaktohet se kush mund të jetë “Qytetar Nderi i Vushtrrisë” dhe kujt mund t’i ndahet “Çelësi i Qytetit”.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, propozoi që nenit 5 t’i shtohet edhe kjo fjali: “...dhe në fushat tjera që janë në dobi për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë, ose që ka kontribuar për çështjen kombëtare”.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Ipet në diskutim publik Draft-rregullorja për caktimin e kritereve dhe mënyrën e ndarjes së shpërblimeve, mirënjohjeve, dekoratave dhe titujve të nderit në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Diskutimi publik fillon nga data 01.06.2012 dhe zgjat deri më 20.06.2012.

6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione, për entitetet publike dhe jopublike (shqyrtimi i dytë).

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të LDK-së propozoi që të hiqet paragrafi 5.2, sepse në këto kushte të rënda ekonomike, kryetari dhe kuvendi nuk po mund t'iu ndihmojë qytetarëve të vet, e lëre më t'iu ndihmojë qytetarëve tjerë jashtë Komunës së Vushtrrisë.

Safet Idrizi, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale- duke iu referuar propozimit të I.Gashit, tha se ndodhin disa raste që kërkohen ndihma nga komuna dhe kuvendi i komunës edhe jashtë Komunës së Vushtrrisë.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- sqaroi se në rastet emergjente edhe pa qenë në rregullore mund të paraqitet kërkesa në kuvend dhe të merrë vendim kuvendi.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 14 vota “për”, 9 “kundër”, të tjerët “abstenim” vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja 01 Nr.37-2/11, dt. 24.02.2011 për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale entiteteve publike dhe jopublike.

7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndërtimet dhe parandalimin e ndërtimeve ilegale gjatë vitit 2011.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- tha se informata në fjalë sipas planit të punës së kuvendit është dashtë të prezantohet në muajin mars dhe shtoi se ky interval kohor prej dymuajsh ka pasur shumë mundësi të keqpërdoret prej atyre që janë të papërgjegjshëm dhe që dëshirojnë ta shfrytëzojnë mungesën e funksionimit të organeve komunale, sepse edhe rasti i arrestimit të drejtorëve ka pasur pasoja edhe në këtë aspekt. Pastaj tha se informata në fjalë është e mangët dhe shtoi se jemi dëshmitarë të ndërtimeve të shumta ilegale, uzurpimit të tokës, ndërrimit të destinacionit të tokës ndërtimore në tokë bujqësore, po ashtu ka shumë raste që edhe në sektorin publik nuk janë përfill standardet e ndërtimit, kushtet teknike. Mandej tha se edhe kryetari i komunës në kuvend e ka pranuar që shumë objekte shkollore që janë ndërtuar nuk i kanë plotësuar kushtet teknike. Në vazhdim tha se sot është problem edhe në tërë Kosovën çështja e ndërtimeve ilegale dhe të mosrespektimit të kushteve teknike, standarde të ndërtimit. Kurse duke iu referuar institutit GAP, i cili ka bërë një studim nëpër komuna në tetor të vitit 2009, ndër të cilat edhe në Vushtrri, ka konstatuar se Vushtrria karakterizohet me ndërtime ilegale, me rrugë shumë të ngushta, prandaj tha se qeveria komunale duhet me qenë shumë më e vendosur në këtë aspekt, dhe shtoi se jemi dëshmitarë të ndërtimeve të reja shumëkatëshe në komunë, por në shumë raste nuk respektohen kushtet teknike dhe standarde të ndërtimit, pasi që ka objekte të larta të ndërtuara afër rrugëve, nuk kanë hapësirë të paraparë për parking, nuk e kanë hapësirën që do të duhej ta parashihnin për gjelbërim. Gjithashtu duke iu referuar Rregullores për ndërtim, në të thuhet se “janë disa kriterë që për çdo objekt që ndërtohet duhet t'i respekton”, duhet të merret edhe pëlqimi i fqinjëve, dhe duke përmendur objektin që është ndërtuar në qendër të qytetit, tha se nuk i është prezantuar kuvendit marrja e pëlqimit nga rrethina. Po ashtu tha se ka objekte tjera që janë ndërtuar afër rrugës, dhe është cenuar hapësira ku do të duhej të ishte trotuar i këmbësorëve, dhe nga kjo nënkuptohet se nuk janë respektuar standardet dhe nga pasojat e korrupsionit edhe në këto raste vërehen, pasi që jepen leje në mënyrë jomeritore. Ndërsa lidhur me investitorët tha se duhet të krijohet një partneritet më i madh në mes të investitorëve

dhe autoriteteve komunale, në mënyrë që të vëhet interesi i përgjithshëm para interesit të investitorëve. Kurse lidhur me rrënimet e ndërtimeve ilegale tha se në informatën në fjalë janë specifikuar rrënimet në fshatin Pestovë dhe Dobërllukë, e që në realitet në fshatrat në fjalë janë rrënuar dy mure të vogla dhe shtoi se organet komunale e kanë për obligim që t'i parandalojnë ndërtimet ilegale. Në fund kërkoi përgjegjësi nga kryetari i komunës që inspeksionin ta përkrah, e nëse ka nevojë edhe të bëjë ndërrime në inspeksion.

Esat Beka, anëtar i kuvendit- e përgëzoi Drejtorinë për Inspektime për punën e mirë që është duke e bërë. Pastaj duke iu referuar diskutimit të B.Jasharit lidhur me objektin e ndërtuar afër komunës, tha se për objektin në fjalë është dhënë leja e ndërtimit para ardhjes së PDK-së në pushtet (para vitit 2007). Mandej tha se problemet kryesore që sot po shfaqen janë si pasojë e pushteteve të kaluara.

Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit- tha se informata në fjalë nuk përmban asgjë, duke shtuar se edhe në tabelarin e paraqitur në informatë ka gabime teknike. Pastaj kërkoi nga Drejtoria për Inspektime që për mbledhjen e ardhshme të KK-së ta paraqesë listën e lejeve ndërtimore të rregullta dhe të përkohshme, dhe të dhënia e lejeve të përkohshme sa është respektuar procedura e ndërtimit.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- tha se lidhur me çështjen e ndërtimeve të paligjshme në të kaluarën, tha se askush nuk mund t'i kërkojë përgjegjësi dikujt tjetër për përgjegjësinë që e ka pasur dikush tjetër dhe shtoi se nëse në të kaluarën nuk janë respektuar rregullat, nuk d.m.th. që edhe sot të vazhdohet dhe të punohet njësoj, por duhet që përmes angazhimit të stopohen ato trende negative.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- lidhur me informatën në fjalë tha se çështja duhet të trajtohet seriozisht, pa prejjudikime dhe të analizohet se sa janë dhënë leje qysh nga viti 1999, për sa kate është dhënë leja, dhe në sa kate janë ndërtuar objektet, cilat objekte janë pranuar teknikisht dhe është dhënë leja e përdorimit, dhe cilat nuk janë pranuar teknikisht, a ka nënshkruar ndonjë përgjegjës për kualitetet e ndërtimeve në rastet e caktuara të përgjithshme. Prandaj çështja duhet të trajtohet detajisht dhe të merren masat konkrete, duke shtuar se vetëm dy inspektorë nuk mund ta bëjnë, por duhet angazhimi maksimal nga përgjegjësi kryesor dhe së bashku me institucionet tjera.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- tha se informata në fjalë është shumë e varfër dhe e pakompletuar, pasi që duhet shikuar që në bazë të ligjit cilat objekte kanë mundur të legalizohen dhe cilat nuk mund të legalizohen, dhe kjo çështje mungon në informatën në fjalë. Pastaj duke iu referuar këtij paragrafi në informatë se: “gjatë kësaj periudhe nuk kemi hasur në asnjë ndërtim ilegal në pronën publike”, prandaj pyeti se a vetëm prona publike duhet të na mbrojë nga ilegaliteti, dhe shtoi se duhet ruajtur edhe prona private, pasi që çdo ditë toka e komasacionit po tjetërsohet. Në vazhdim tha se në kilometrin e tretë në rrugën që të dërgon nga Vushtrria për në Bukosh, shihet se tokat komasative për çdo ditë po zihen, dhe në ato toka është zhavorr dhe material inert dhe janë vendosur disa shtëpiza provizore, me qëllim që në të ardhmen të ndërtohet diçka nga materiali i fortë.

Bajram Beqiri, drejtor i Drejtorisë për Inspektime- në fillim paraqiti arsyetimin pse informata në fjalë nuk iu është prezantuar kuvendit në muajin mars, pastaj tha se kjo informatë ka mundur të nxirret edhe nga raporti vjetor i punës, të cilin të gjithë anëtarët e kuvendit e kanë pas në dispozicion. Gjithashtu tha se nga Drejtoria për Inspektime është kërkuar raport vjetor, e jo raport 50-vjetor, pasi që nga anëtarët e kuvendit u përmenden ndërtesa të ndërtuara para 50-100 viteve. Kurse duke iu referuar diskutimit të B.Jasharit lidhur me rrënimet ilegale në fshatin Dobërllukë, tha se janë rrënuar 32 objekte. Në vazhdim duke iu referuar çështjes së ndërrimit të destinacionit të tokës, tha se nuk është kërkuar raport edhe pse kjo çështje është kompetencë e Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Ndërsa sa i përket ndërtimeve shumë katëshe, tha se janë dhënë lejet urbanistike dhe ndërtimore, duke sqaruar se Drejtoria për Urbanizëm në bazë të ligjit është kompetente t'i jap leje të

gjithë atyre që kërkojnë leje dhe që i plotësojnë kushtet urbanistike, prandaj ata që pajisen me leje e kanë edhe pëlqimin nga inspeksioni. Në vazhdim tha se B.Jashari e përmendi disa herë çështjen e korrupsionit, prandaj e ftoi anëtarin e kuvendit në fjalë që nëse ka ndonjë rast konkret, le ta publikon në kuvend dhe nëse ka raste të tilla, do të jepë dorëheqje nga pozita e drejtorit. Mandej tha se viti 2011 ka qenë viti më i suksesshëm në historinë e Komunës së Vushtrrisë, sa i përket lejeve ndërtimore, duke shtuar se ka pas një tejkalim prej 280 % në raport me vitin 2010. Në fund lidhur me legalizimet tha se nuk është detyrë e inspeksionit që ta seleksionojë listën për legalizim, dhe shtoi se ka një mungesë të ligjit për ndërtime në tërë Kosovën.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- tha se iu referohet edhe gazetës “Zëri” ku në një shkrim të saj, kryetari i komunës ankohet për mosefikasitet në inkasimin e të hyrave, dhe në këtë rast përmend edhe drejtorin e inspeksionit. Pastaj tha se edhe inspeksioni meriton përkrahje, duke shtuar se inspektori duhet të ketë dinjitet dhe të ketë uniformën dhe logon që tregon se është përfaqësues i shtetit. Pastaj duke iu referuar çështjes së korrupsionit, tha se korrupsion është kur diçka nuk punohet sipas cilësisë dhe standardeve që është dashtë të ndërtohet dhe si shembull përmendi rrugën në Tërllabuq, që menjëherë pas ndërtimit ka filluar të gërvishet dhe kjo dëshmon cilësinë e dobët të ndërtimeve.

8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit mbi lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të LDK-së shprehu shqetësimin lidhur me pëlqimin (për propozim-vendimin në fjalë) që e ka dhënë Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, e cila thirret në dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut mbi kompetencat e qeverisë, kur dihet që është Rregullorja mbi fushat e përgjegjësisë së Qeverisë së Kosovës, ku përcaktohen edhe kompetencat. Gjithashtu paraqiti shqetësimin që Drejtoria për Urbanizëm ka paraqitur një kopje të planit me shkronja cirilike, duke shtuar se drejtoria në fjalë ka mundur të nxjerrë planin në gjuhën shqipe nga hartat, prandaj Grupi parlamentar i LDK-së e përkrah propozim-vendimin në fjalë, por pa kopjen e planit me shkronja cirilike.

Xhemajl Pllana, anëtar i kuvendit- tha se qeveria lokale duhet t’i mbrojë tokat e veta, të cilat po shkatërrohen çdo ditë, prandaj kërkoi që të analizohen mirë edhe pëlqimet që jepen nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 32 vota “për”, 1 “abstenim” vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim lejohet ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, e cila është e evidentuar në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL-70202010-00217, parcela kadastrale: nr.57/4, vendi i quajtur “pruga” me kulturë arë e klasit të tretë, në sipërfaqe prej 0.24.60 ha, ZK Bukosh, Komuna Vushtri, pronë e Islam Hysenit nga fshati Bukosh.

9. Shqyrtimi i kërkesës së tri shoqatave të dala nga lufta rreth financimit të tyre.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të PDK-së e përkrahu kërkesën e tri shoqatave të dala nga lufta, duke i propozuar kryetarit të komunës që nga subvencionet t’ua ndanë 3.000 € shoqatave në fjalë.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- lidhur me kërkesën në fjalë, tha se duhet mbështetur këtë kërkesë, në mënyrë që duke kursyer nga luksi i shpenzimeve telefonike, drekave, dhe shpenzimit të naftës së komunës, ku ka pasur rritje të

shpenzimeve, t'iu krijohen disa kushte modeste për punë këtyre kategorive, duke kërkuar përkrahje institucionale në mënyrë kontinuele.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- tha se dy mbledhje më përpara të kuvendit të komunës, të gjithë anëtarët e kuvendit i kanë përkrahur kërkesat e tri shoqatave të dala nga lufta. Pastaj duke iu referuar kërkesës në fjalë të tri shoqatave të dala nga lufta, tha se për anjërën shoqatë nuk figuron emri i ndonjë përfaqësuesi të tyre.

Esat Beka, anëtar i kuvendit- sqaroi se në mbledhjen e kaluar kuvendi i komunës ka vendosur që t'ua ulë shumat e propozuara nga qeveria lokale tri shoqatave të dala nga lufta, duke i barazuar shumat për shoqatat e dala nga lufta me shoqata tjera. Pastaj tha se tri shoqatat e dala nga lufta janë shembull pozitiv për të mbajtur paqen dhe qetësinë në vend.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- tha se ne jemi në këtë kuvend, falë luftës çlirimtare. Pastaj kërkoi nga kryetari i komunës që ta gjejë formën (nëse është e lejueshme me ligj) që të financohen në mënyrë të rregullt tri shoqatat e dala nga lufta, e jo shoqatat e dala nga lufta të paraqesin kërkesa me shkrim për financimin e tyre.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- tha se AAK-ja ka kundërshtuar formën e futjes në rend dite të kësaj çështje, duke mos kaluar përmes KPF-së, por grupi parlamentar në fjalë ka ndryshuar qëndrim pasi që është thënë se është nevojë urgjente aprovimi i vendimit për t'ua mundësuar regjistrimin klubeve sportive. Pastaj tha se ka qenë dhe është që shoqata "Martirët e Lirisë" të trajtohet më mirë, prandaj askush nuk ka thënë që shoqatave të dala nga lufta t'iu zvogëlohen shumat. Në vazhdim tha se i përkrah kërkesat e shoqatave të dala nga lufta, kërkesat e ish të burgosurve politikë dhe të shoqatës së martirëve.

Dibran Përçuku, nënkryetar i komunës- duke iu referuar kërkesës në fjalë, tha se shoqatat e dala nga lufta nuk kanë kërkuar luks, por kanë shpenzimet pa paguar për rrymë, ujë dhe për inventar. Pra, kanë kërkuar një shumë shtesë brenda këtij viti. Në fund propozoi që nëse ka mjete prej subvencioneve, të autorizohet kryetari i komunës që tri shoqatave të dala nga lufta t'iu ndahen mjete shtesë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim autorizohet Kryetari i Komunës që të angazhohet për shqyrtuar kërkesën e tri shoqatave të dalura nga lufta për t'iu ndarë mjete shtesë financiare për vitin 2012, për mbulimin e nevojave të tyre.

10. Shqyrtimi i Informatës për fëmijët që punojnë punë të rënda.

Remzije Zekolli, koordinatorë e Njësitit Komunal për të Drejtat e Njeriut- paraqiti sqarimet hyrëse lidhur me informatën në fjalë.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, tha se nga kjo informatë po nënkuptohet se Komiteti për Parandalimin dhe Eliminimin e Punëve më të Rrezikshme për Fëmijët është vetëm për identifikimin e disa problemeve. Pastaj tha se në këtë informatë janë identifikuar disa raste ku fëmijët punojnë punë të rrezikshme, por nuk ka informatë se çka është ndërmarrë konkretisht, dhe shtoi se kuvendi duhet ta mbështesë më shumë komitetin në fjalë në aspektin moral dhe material dhe propozoi që komiteti në fjalë të ketë mëditje, në mënyrë që të ketë punë efikase nga komiteti, e nëse nuk funksionon, propozoi që komiteti të rizgjedhet apo të plotësohet me anëtarë të rinj. Në vazhdim tha se kjo çështje është shumë me rëndësi dhe theksoi se gjatë diskutimit në KPF për këtë çështje, e kanë lëshuar mbledhjen anëtari AAK-së dhe dy anëtarët e PDK-së. Në fund tha se për çështjen e fëmijëve që punojnë punë të rënda mund të realizohen edhe këto aktivitete: sensibilizimi i popullatës, mbajtja e tryezave me temën në fjalë, marrjen e masave në raste konkrete materialisht apo moralisht dhe shtoi se UNICEF-i në raportin e vet ka

kritikuar se në Kosovë shkelen të drejtat e fëmijëve, prandaj shtoi se është koha e fundit që të merren masa.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë tha se ky hap le të jetë një fillim i mbarë, pasi që ka edhe fëmijë të tjerë që merren me punë që nuk iu takojnë, e që nuk janë të përfshirë në këtë informatë. Pastaj tha se shumë fëmijë që janë në shkolla paradite, pasdite ata janë punëtorë në treg, duke shtuar se ka fëmijë që punojnë si saldues dhe si xhamprerës, prandaj i sugjeroi komitetit komunal për të drejtat e fëmijëve, njësitit komunal për të drejtat e fëmijëve dhe njësitit të policisë në komunitet për t'i identifikuar këto raste dhe të punojmë të gjithë së bashku për sensibilizimin për këtë çështje dhe për të parandaluar fëmijët nga punët e rënda që nuk iu takojnë. Në fund tha se ka raste që disa fëmijë pa prindër keqpërdoren nga familjarët tjerë.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- tha se informata në fjalë është e dobishme për anëtarët e kuvendit dhe shtoi se duhet të kërkohet nga kuvendi i komunës që të mbështet këtë njësi për ndonjë projekt të caktuar, prandaj do të ishte mirë që t'i prezantohet kuvendi ndonjë nevojë e kësaj njësie, në mënyrë që të ndikohet për përmirësimin e gjendjes. Në fund tha se komuna duhet t'i respektojë dhe përkrah investitorët e brendshëm, pasi që këta janë krijuar të vendeve të reja të punës, dhe në këtë mënyrë përmirësohet situata ekonomike, prandaj duke e përmirësuar situatën ekonomike, mund t'i largojmë fëmijët nga rruga.

11. Të ndryshme:

a. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe harmonizimin e rishikimit të buxhetit për vitin 2012.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- paraqiti sqarimet hyrëse lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- tha se Grupi parlamentar i PDK-së e përkrah propozim-vendimin në fjalë.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- tha se vendimi që është aprovuar në vitin 2010, që është rruga në Novolan, lagjja "Ferizi" dhe lagjja "Islamaj" në Kollë duhet të zbatohet në tërësi, prandaj propozoi që rruga në fjalë të hyjë si pako.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë tha se për hir të seriozitetit të çështjes, Grupi parlamentar i LDK-së pajtohet që të hyjë propozimi i S.Kadriut dhe të hyjë edhe propozimi që kërkon pak mjete i komunitetit të fshatit Skoqne, për shtrimin e rrugës së tyre në zhavorr dhe t'iu dërgohet edhe energjia elektrike.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- tha se Grupi parlamentar i AAK-së i mbështet propozim-vendimin në fjalë, duke inkorporuar propozimet e S.Kadriut dhe R.Ramajt. Gjithashtu propozoi që nëse ka mundësi, komuna ta krijojë një fond rezervë.

Dibran Përçuku, nënkryetar i komunës- duke iu referuar propozimeve shtesë, tha se nuk ka mjete për to, pasi që kuvendi i komunës e ka aprovuar buxhetin më herët, dhe shtoi se komuna nuk mund ta instalojë energjinë elektrike në Skoqne, pasi që është kompetencë e KEK-ut.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 16 vota "për", 15 "kundër", të tjerët "abstenim" vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim bëhet rishikimi i mjeteve të buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2012, në bazë të Ligjit të Buxhetit për vitin 2012 të MEF-it, dhe kërkesave të programeve buxhetore të komunës.

Gjithashtu Kuvendi pas votimit me 16 vota "për", 15 "kundër", të tjerët "abstenim" vendosi me sa vijon:

Aprovohet propozimi i S.Kadriut për asfaltimin e segmentit rrugor të lagjes "Ferizi" në fshatin Kollë gjatë vitit 2012.

b. Shqyrtimi i listës së propozuar nga komisioni për ndarjen e plaketave dhe mirënjohjeve.

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të PDK-së e mbështeti listën e propozuar nga komisioni, dhe njëkohësisht paraqiti edhe këto propozime shtesë: plaketë (post mortum) për Enver Zymberin; mirënjohje për: gjimnazin “Eqrem Qabej” për rezultatet e arritura në nivel vendi; Kryqit të Kuq në Vushtrri, për punën dhe angazhimin e bërë për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë; Mexhit Merovcit- mërgimtar, për donacionet e dhëna për ndërtimin e shtëpive.

Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit- tha se Dr. Shaban Merovci duhet të jetë në renditje para Dr. Agim Drevinjës, pasi që është doajen i shëndetësisë kosovare dhe komunale, si dhe është themelues i shkollës së mesme të mjekësisë në Mitrovicë. Pastaj tha se sh.f. “Bahri Kuqi” në Shtruhërë për shkak të rezultateve të larta në procesin mësimor-edukativ dhe aktivitetet e lira në nivel regjional, republikan dhe ndërkombëtar propozoi që në vend të mirënjohjes, t’i jepet plaketë.

Islam Krasniqi, anëtar i kuvendit- propozoi për plaketë Shemsi Rrahimin (kryetar i Bashkësisë Islame në Vushtrri), për kontributin e dhënë në aspektin fetar dhe kombëtar, kurse për mirënjohje propozoi Mexhit Përçukun, për rezultatet e arritura në punë në lëmin e financave në Komunën e Vushtrrisë.

Xhylsime Feka, anëtare e kuvendit- tha se mirënjohjet dhe plaketat duhet t’u ndahen atyre personave që me punën e vet kanë kontribuar për këtë shoqëri dhe për këtë qytet, dhe jo të futen edhe emra që për punën e vet marrin pagë, kurse shtoi se janë të tepërta propozimet për mirënjohje nr. 25 dhe 26, pasi që të propozuarat janë punëtore të arsimit dhe nëse janë punëtore të dalluara, le t’ua ndanë kolektivi i tyre në rastin e shënimit të “Ditës së Mësuesit”. Në fund propozoi që t’i ndahet mirënjohje nxënësit Arbnor Gashi, për rezultatet e arritura në lëmin e matematikës.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- propozoi për plaketë Abdyl Ukën, i cili ka bërë një akt atdhetarie duke e mbrojtur nderin e familjes dhe më gjer, kurse propozoi t’i ndahet mirënjohje Mursel Bllatës (post mortum), i cili ka qëndruar në shtëpinë e vet për ta mbrojtur familjen dhe nderin, duke u vrrarë nga forcat serbe.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- propozoi që t’i ndahet plaketë Mejreme Ismajlit, në shenjë nderimi dhe respekti, për shkak të kontributit që ka dhënë ndaj të plagosurve gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- lidhur me mospjesëmarrjen e tij në komisionin e formuar për ndarje të plaketave dhe mirënjohjeve, tha se nuk ka marrë pjesë në komisionin në fjalë, pasi që nuk ka dashtë të merrë përgjegjësi, pa pas një rregullore me kritere për ndarjen e këtyre mirënjohjeve.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit- tha se Grupi parlamentar i AAK-së e mbështet propozimin e S. Kadriut për ndarje të paketës për Mejreme Ismajlin, duke shtuar se nuk ka asnjë problem edhe pse ka qenë kryetare e komisionit, pasi që kuvendi po e propozon.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 30 vota “për”, 3 “abstenim” vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim për nder të Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, më 17 qershor 2012, nderohen me plaketa dhe mirënjohje siç vijon:

PLAKETA:

- 1. Enver Zymberi – (Post mortum) për kontributin e dhënë në mbrojtjen e integritetit shtetëror të Republikës së Kosovës.**
- 2. Brahim Gjaka - (veteran i UÇK-së) për kontribut të dhënë gjatë luftës në Kosovë.**
- 3. Habib Kamberi (veteran i UÇK-së) për kontribut të dhënë gjatë luftës në Kosovë.**

4. **Sami Krasniqi - (Post mortum) invalid i plagosur në luftën e Kosovës, i cili nga plagët e marra ka vdekur pas luftës.**
5. **Sadik Idrizi - (Post mortum) invalid, i plagosur në luftën e Kosovës, i cili nga plagët e marra ka vdekur pas luftës.**
6. **Beshir Krasiniqi - (Post mortum) invalid i plagosur në luftën e Kosovës, i cili nga plagët e marra ka vdekur pas luftës.**
7. **Lutfi Islami - (Post mortum) invalid i plagosur në luftën e Kosovës, i cili nga plagët e marra ka vdekur pas luftës.**
8. **Sefedin Morina - (Post mortum) invalid i plagosur në luftën e Kosovës, i cili nga plagët e marra ka vdekur pas luftës.**
9. **Vesel Shyti - (Post mortum) invalid i plagosur në luftën e Kosovës, i cili nga plagët e marra ka vdekur pas luftës.**
10. **Sabri Maxhuni Novosella – për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare.**
11. **Bali (Ibish) Dervishi – (ish i burgosur politik) për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare.**
12. **Islam (Hasan) Mulaku- për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare.**
13. **Dr. Shaban Merovci – (Post mortum) për kontributin e dhënë në fushën e shëndetësisë.**
14. **Dr. Agim Drevinja – (Post mortum) për kontributin e dhënë në fushën e shëndetësisë.**
15. **Dr. Safet Rexha – për kontributin e dhënë gjatë luftës së fundit në Kosovë.**
16. **Shemsi Rrahimi – kryetar i BI-së në Vushtrri, për kontributin e dhënë në çështjen fetare dhe kombëtare.**
17. **Abdyl Uka – për akt trimërie në mbrojtjen e nderit të familjes.**
18. **Dr. Mejreme Ismajli – për kontributin e dhënë ndaj të plagosurve gjatë luftës në Kosovë.**
19. **SHMU “Bahri Kuqi” – për rezultate të larta në procesin mësimor dhe edukativ në nivelin regjional, shtetëror dhe ndërkombëtar.**
20. **Kudusi Lama - për kontributin e dhënë për çështje kombëtare.**
21. **Aziz Zhilivoda - për kontributin e dhënë për çështje kombëtare.**

MIRËNJOHJE:

1. **Remzi Prronaj – për kontribut të dhënë gjatë luftës së fundit në Kosovës.**
2. **Behram Rrahmani – për kontribut të dhënë gjatë luftës së fundit në Kosovë.**
3. **Shukri Ademi – për kontribut të dhënë gjatë luftës në Kosovë.**
4. **Sanie Bajrami-Qosi – (ish-arsimtare) e burgosur, e cila dha kontribut në mbrojtjen e shkollës shqipe.**
5. **Akile Dedinca-Zhegrova – për kontributin e dhënë për çështje kombëtare.**
6. **Dinore Sheremet- Curri – për kontributin e dhënë për çështje kombëtare.**
7. **Fazli Isa Ademi – (post mortum) ish i burgosur politik.**
8. **Ajet Ferat Berisha – për kontributin e dhënë për çështje kombëtare.**
9. **Mexhide Shoholli – për kontributin e dhënë në lëmin e infermierisë.**
10. **Dr. Safet Idrizi – për kontributin e dhënë në lëmin e shëndetësisë.**
11. **KH “Samadrexha” (M) – për suksese të larta në garat në nivel vendi.**
11. **KF “Kosova”- për rezultatet e arritura në futboll.**
12. **Klubi i Volejbollit “Gjimnazisti” – për arritje të rezultateve të larta në nivel komunal, regjional dhe në nivel të Kosovës.**
13. **OJQ Rinore “Lëvizja Koha”- për aktivitete të suksesshme me të rinjtë e Komunës së Vushtrrisë.**
14. **Fazli Muharremi – për kontributin e dhënë si aktor dhe regjisor në teatrin në Vushtrri.**
15. **Musa Fejzullahu – për kontributin e dhënë në lëmin e muzikës dhe aktrimin në Vushtrri.**
16. **Isuf Zhegrova – për të arriturat në lëmin e biznesit.**

17. **Kotex-i** – për kontributin e dhënë në prodhimet e konfeksionit të lehtë.
18. **Molitoria nga Bukoshi** – për kontributin e dhënë në grumbullimin dhe përpunimin e drithërave.
19. **Emona Center- Vushtrri**– për biznes të suksesshëm brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës.
20. **Driton Morina nga Akrashtica**– për prodhimtari të lartë në bujqësi.
21. **Sabedin Hajredinaj nga Stanoci i Epërm-** fermer i dalluar në blegtori.
22. **Sedat Kasumi nga Pestova** – për arritjen e rendimenteve të larta në kultivimin e patates.
23. **Vjendita Pllana- në SHMU “Bahri Kuqi”,** për sukseset e arritura në garat kombëtare të organizuara nga Instituti i Gjuhës “Gjuhëtari i Ri”.
24. **Merita Ademi** – arsimtare e dalluar e matematikës në SHMU “Bahri Kuqi” Shtruhërë.
25. **Vjollca Pllana** – arsimtare e dalluar e gjuhës dhe letërsisë shqipe në SHMU “Bahri Kuqi” Shtruhërë.
26. **Muhamet Xhemajli (post mortum)- ish-drejtor** në SHMU “28 Nëntori” në Vërnice, për kontributin e dhënë në themelimin e kësaj shkolle.
27. **Afërdita Dervishi** – inxh. e diplomuar, e persekutuar, e përndjekur dhe e dënuar padrejtësisht nga regjimi i asaj kohe.
28. **Ferki Kadriu nga Novolani** – bujk i suksesshëm.
29. **KV nga Shtruhëra** – për sukseset e arritura në volejball.
30. **SHM Gjinnazi “Eqrem Qabej”** – për rezultatet e arritura në nivel të Republikës së Kosovës.
31. **Mexhit Merovci** – mërgimtar, për kontributin e dhënë për ndërtimin e shtëpive për familjet e pastrehë.
32. **Kryqi i Kuq (Vushtrri)**– për kontributin e dhënë në shërbim të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.
33. **Mexhit Përçuku** – për rezultate në punë në lëmin e financave.
34. **Mursel Bllata** – (post mortum) për akt trimërie në mbrojtjen e nderit të familjes.
35. **Arbnor Gashi** – (nxënës) për rezultatet e arritura në lëmin e matematikës.

c. Shqyrtimi i propozimit për plotësimin e KPF-së me një anëtar.

Xhylsime Feka, anëtare e kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të PDK-së propozoi Shpëtim Zhegrovën për anëtar të KPF-së.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim emërohet Shpëtim Zhegrova (PDK) anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) i KK-së në Vushtrri.

ç. Shqyrtimi i Deklaratës lidhur me kërkesat e pensionistëve për gjendjen e tyre tejet të rëndë sociale.

Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime miratoi këtë:

DEKLARATË

Duke u bazuar në gjendjen e rëndë sociale të pensionistëve në Kosovë, të cilët kanë mbetur pa përkrahje materiale dhe shëndetësore, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë përkrah kërkesat e tyre të drejta, që kanë të bëjnë me përmirësimin e jetës së tyre.

Njëherit Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë kërkon nga organet kompetente të shtetit të Kosovës që ato kërkesa të arsyeshme t'i miratojnë në mënyrë që të zgjidhet statusi i tyre sa më parë.

Prandaj, është obligim dhe përgjegjësi që kjo kategori e popullatës të ketë një jetë të dinjitetshme.

d. Pyetjet eventuale të anëtarëve të kuvendit.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar informatës se kryetari i komunës ka realizuar takim me zv. Ministrin e Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, dhe në takimin në fjalë, zv. ministri ia ka prezantuar kryetarit të komunës faktin se Vushtrria është ndër komunat e para që i ka fryrë listat e përfituesve të ndihmave sociale, dhe në bazë të informatës që është dhënë, thuhet se Vushtrria i ka 1864 përfitues të ndihmave, kurse kryetari i komunës ka premtuar se do të marrë masa në mënyrë që të rishikohet dhe të pastrohet lista duke i hequr nga lista përfituesit e paligjshëm, prandaj pyeti kryetarin e komunës se çka është ndërmarrë në përbushjen e këtij premtimi nga ana e kryetarit?

Syzana Sylja, anëtare e kuvendit- në emër të qytetarëve që banojnë përgjatë lumit "Tërstenka" kërkoi që të vendosen shenja të komunikacionit një kakshe, të kufizimit të shpejtësisë dhe shenjat e mbajtjes së peshës së automjetit, mirëpo kërkesa e tyre nuk është përfillur dhe rruga është e ngushtë, ndërsa qytetarët ngasin automjetet me një shpejtësi të madhe. Pastaj pyeti se a është kërkuar me shkrim nga institucionet komunale për policinë që të vëzhgohet përgjatë lumit "Tërstenka", pasi që qytetarët kanë vendosur pengesa sipas dëshirës së tyre dhe ka pasur edhe dëmtime të tjera të rrugës, në trotualet dhe muret përgjatë lumit si dhe rrethojat e lumit në fjalë. Gjithashtu, tha se tek ambulanca e vjetër është dëmtuar gypi i cili përcjellë ujin, prandaj pyeti se a është kërkuar nga kompania përgjegjëse eliminimi i këtij defekti. Mandej pyeti Drejtorinë për Prokurime se a kanë përfunduar punimet në lumin "Tërstenka" dhe a është bërë pranimi teknik i projektit në fjalë? Në fund paraqiti propozimin e drejtorisë së shkollës "Naim Frashëri" për vendosjen e zebrave (vijave të bardha) në udhëkryqin afër memorialit të dëshmorëve, pasi që ka frekuentime të mëdha nga nxënësit, dhe paraqitet rrezik për ta.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- paraqiti shqetësimin lidhur me kualitetin e dobët të dy rrugëve që kanë përfunduar për kontratat e nënshkruara publike, pra bëhet fjalë për rrugën në fshatrat Sllatinë-Tërllabuq, e cila ka kushtuar 78.953 €, kurse pas 5-6 muajve rruga është në gjendje të keqe, dhe shtoi se Komuna e Vushtrrisë në vitin e kaluar ka shpenzuar 45.000 € për mbikëqyrje dhe hartim të projekteve, dhe 60.000 € janë shpenzuar për hartim të projekteve, dhe rikujtoi se kryetari i komunës ka deklaruar se gjatë mandatit të tij nuk do të realizohet asnjë projekt kapital pa projekte, dhe shtoi se përveç komunës që ka bërë projekte, edhe qytetarët investojnë në projekte, kurse realizohen me paramasë dhe paralogarit, pastaj tha se sikur të realizohej me projekt rruga Sllatinë-Tërllabuq, nuk do të ishte në atë gjendje, siç është tani. Gjithashtu edhe rruga stacioni i trenit-Bukosh, pjesa e dytë ku janë të fotografuara dëmtimet ka kushtuar 52.511 €, dhe në fund tha se të dy rrugët në fjalë janë kryer nga i njëjti punëkryerës.

Islam Krasniqi, anëtar i kuvendit- kërkoi nga organet komunale që banorëve të lagjes "Hajrizaj" në fshatin Bukosh t'u ofrohet një zgjidhje për furnizimin me ujë të pijshëm, duke propozuar furnizim me ujë përmes "cisternës" apo formave tjera.

Veli Karaça, anëtar i kuvendit- kërkoi nga autoritetet komunale që gjatë rishikimit të buxhetit të shqyrtohet mundësia për shtrimin e rrugës Skoqne, në mënyrë që të bëhet e kalueshme, duke shtuar se fshati në fjalë është boshatisur disa vite më parë nga fshatarët në radhë të parë për shkak të mungesës së energjisë elektrike, pastaj mungesës së rrugës, shkollës dhe të gjitha objekteve tjera publike. Gjithashtu tha se rruga në fjalë ka nevojë që të bëhet e kalueshme, pasi që ka pasuri natyrore dhe

njerëzit kanë prona, prandaj me rishikim të buxhetit propozoi që të hapet rruga dhe të shtrohet me një material të qëndrueshëm. Në fund tha se duhet të jetë politikë e institucioneve lokale që fshatrat të përkrahen dhe banorët të jetojnë në to, kurse të tjerëve t'iu krijohen kushtet për kthim në fshatrat e tyre.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- e mbështeti propozimin e V.Karaçës për fshatin Skoqne. Pastaj kërkoi që të pastrohet nga mbeturinat lumi “Studime” në hyrje të qytetit, dhe “Podrança” në dalje të qytetit. Mandej pyeti se çfarë po ndodh me fabrikën e qumështit në Nedakoc, dhe shtoi se janë bërë 3 vite dhe nuk ka ardhur asnjë arsyetim për ngecjen e punëve të saj. Në vazhdim pyeti pse është lënë anash rruga “Haxhi Zeka”, e cila është rrugë dytësore, dhe e cila do ta shkarkonte rrugën kryesore “Gj.K. Skënderbeu”. Tutje kërkoi që të futen në prioritet rrugët e vështira për lagjet “Menxhiqi dhe Xhafa” në fshatin Sfaraçak. Po ashtu pyeti pse është anashkaluar rruga te ish-shtëpitë-shkolla të Halim Mërnicsës, pasi që rruga në fjalë e meriton të futet në prioritet. Në fund tha se pronat e komunës (me male) po uzurpohen dhe dëmtohen, pra po tjetërsohen, prandaj pyeti se a ka kushte dhe mundësi që ato prona të identifikohen dhe të shenjzohen për t'i mbrojtur nga keqbërësit.

Mbledhja përfundoi në orën 15:25.

Procesmbajtësi
Albanez Tahiraj

Kryesuesi i Kuvendit
Habib Mustafa

Lektore
Vlora Krasniqi